

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: “Shërbim lyerje të godinës nr.36 Garnizoni “Skënderbej”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 98316000-1, Shërbime lyerjeje

Vlera e fondit limit: 2,916,505.72 (dy milion e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e pesë pike shtatëdhjetë e dy)lekë pa TVSH

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 30 (tridhjetë) ditë

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerje të Përqëndruara sh.a.**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojcës 9 të DST

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1 Kopje të deklaramentit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2022, 2023, 2024) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 35 % e fondit limit të kontratës që prokurohet. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2/a dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar). Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.2 Kapaciteti teknik:

- 2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 19% e vlerës së përllogaritur të objektit që prokurohet.
- a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të realizuara.
 - b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Duke qenë se kjo procedurë prokurimi do të konkludojë me një kontratë shërbimi mbikqyrje për të deshmuar përvojën e mëparshme vlera totale e kërkuar duhet të jetë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- 2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Licencë profesionale të shoqërisë**, të lëshuar nga institucioni përgjegjës i ngarkuar me ligj, të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës, ku të përfshihen të paktën **kategoritë** e mëposhtme:

- **NS-4 A** (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik, xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese).

Argumentimi: Kategorite e kerkuara janë kërkuar bazuar ne sherbimin qe do te realizohet sipas objektit te prokurimit.

Kjo kërkesë është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ”a” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), si dhe ne Vendimin e Keshillit të Ministrave nr. 759 datë 28.12.2016 (i ndryshuar).

2.3.3 Një punësim minimalisht prej **10** (dhjetë) punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.
- b. Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per muajin e fundit te deklaruar.

Argumentimi: Këto kërkesa për stafin janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ”c” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri per fuqine punetore eshte bere ne perputhje me realizimin e suksesshëm te sherbimit për objektin.

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, te perfshire ne licensen e shoqerise, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, konkretisht:

1 (një) Inxhinier Ndërtimi

Argumentimi: Spas Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar Neni 77 Kërkesat për kualifikim, pika 4 Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, të cilët duhet te evidentohen në menyre deklarative në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si më poshtë:

- 6 (gjashtë) Bojaxhinj;
- 1 (një) Shofer;

- Per punonjësit **Bojaxhinj**,
OE duhet te paraqesë:
 - Një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë).
 - Kontrate pune perkatese.
 - Listpagesa për muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.
- Per punonjësën **Shofer** ,
OE duhet te paraqesë:
 - Kontrate pune perkatese.
 - leje drejtimi,/Patente nga DPSHTRR.
 - Listpagesa për muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

Argumentimi: Spas Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar Neni 77 Kërkesat për kualifikim, pika 4 Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

2.3.6 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kete si staf mbështetës (me kontrate pune/ kontratë bashkëpunimi) si më poshtë:

1 (një) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për punonjësit e mësipërm Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratat individuale të punës (të vlefshme).
- Diplomë/Çertifikatë

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për *Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, “*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*“, sipas të cilit: „*Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....*“.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i çertifikuar si

"Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a) Certifikatën e cilësisë së punimeve **SSH/EN/UNI ISO 9001-2015** e përditësuar, e vlefshme/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b) Certifikatën **SSH/ EN/UNI ISO 45001:2018** e përditësuar, (SSH/EN/UNI ISO 45001 – 2023) e vlefshme/ ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë ose ekuivalent). Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik do të paraqesë ISO-t në baze të zerave të punimeve që ka marrë persiper të realizojë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH/EN/UNI mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.8 gërma "a"- "b" janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: "Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë", si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ku përcaktohet se: "Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit".

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do

të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtare, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.3.8 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës konkretisht:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi/cope	Statusi
1	Kamioncin	copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Makineri automatike per miksim bojrash	copë	1	Në pronësi ose me qera
3	Pompe boje	copë	1	Në pronësi ose me qera

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Nr. 10 të DST.

- Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) leje qarkullimi; b) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); c) siguracion mjeti (i vlefshëm);
- Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse e Qerasë/huapërdorjes e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) leje qarkullimi; c) çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm);
- Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes, ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Nr. 10 të DST.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me Nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39,

pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar. Nepermjet ketyre kerkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kane në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qellim permbushjen me sukses te kontratës objekt prokurimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhena të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Njësia e Prokurimit: